



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-041

Prishtinë, më 29 nëntor 2011, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 29 NËNTOR 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit,

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Burim Ramadani, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Duda Balje.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Bilall Sherifi dhe Skender Reçica,

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca,

Nga OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 14 nëntor 2011,
2. Përgatitjet për mbledhjet plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave,
4. Të ndryshme.

Në fillim, kryetari njoftoi Kryesinë e Kuvendit lidhur me pikat e rendit të ditës, që ishin hequr nga rendi i ditës i mbledhjeve plenare të mëparshme. Ai propozoi që ato pika t'i procedohen Kuvendit për të vendosur lidhur me to.

Kryesia mbështeti propozimin e kryetarit që mbledhjes plenare, më 7 dhjetor 2011, t'i riprocedohen këto pika:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, dhe
2. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Ndërsa, lidhur me propozimin e Komisionit Ad-hoc parlamentar për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Komisionit Ad-hoc për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, me përbërje të njëjtë, që ta rishqyrtojë edhe njëherë përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media dhe Kuvendit t'ia paraqes Raportin me rekomandime.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 29 nëntor 2011

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 29 nëntor 2011, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjet e ardhshme plenare

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi t'i mbajë dy mbledhje plenare në fillim të dhjetorit 2011.

Mbledhja plenare, më 7 dhe 8 dhjetor 2011, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Interpelancë me ministren e Tregtisë dhe Industrisë, znj. Mimoza Kusari-Lila, lidhur me masat e reciprocitetit me Serbinë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për marrëdhëniet e detyrimeve,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për lojërat e fatit,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sistemin e adresave,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
13. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me Auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për vitin 2010,
14. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim,
15. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me performancën e ndërmarrjeve publike, për vitin 2010.
16. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Mbledhja solemne, më 10 dhjetor 2011, me këtë:

Rend dite

1. Shënimi i 10 vjetorit të punës së Kuvendit të Kosovës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave:

3.1 Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin e shpenzimeve të Kuvendit për nëntëmujorin e vitit 2011

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e cekur më lartë, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për nëntëmujorin e vitit 2011, sipas pasqyrave të paraqitura në këtë raport.

3.2 Përgjigjja e deputetit Ramë Vataj, i mbështetur nga grupi i deputetëve nënshkrues, lidhur me propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Kryesia, pasi shqyrtoi përgjigjen e cekur më lartë, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Grupi i deputetëve mund të fillojë hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Hartuesi i këtij projektligji duhet të veprojë në bazë të Ligjit për nisma legislative dhe Rregulloren e Kuvendit të Kosovës, për hartimin e projektligjit.

3.3 Rekomandimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me kërkesën e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për për zgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2011

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e cekur më lartë, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Autorizohet Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike që, në bashkërendim me Administratën e Kuvendit, përkatësisht me Departamentin e Prokurimit të bëjë përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2011.

2. Vlerësimin e ofertave e bën Komisioni vlerësues, i përbërë nga anëtarët e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

3. Pas përfundimit të procedurave, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e njofton Kryesinë e Kuvendit për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2011.

3.4 Kërkesa e drejtorit të Teatrit profesionist “Istref Begolli”-Pejë, për mbështetje financiare

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lartë, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që, në bazë të Projektit të prezantuar nga Teatrit profesionist “Istref Begolli”-Pejë, “Baladë për Bardhosh e Jusuf Gërvallën dhe Kadri Zekën”, të shqyrtojë mundësinë për mbështetje financiare për realizimin e këtij projekti.

3.5 Kërkesa e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut për përkrahje financiare, për vitin 2012

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lartë, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione që ta shqyrtojë kërkesën e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut për përkrahje financiare, me qëllim të vazhdimit të qëndrueshëm të punës monitoruese të Këshillit, për vitin 2012.

3.6 Njoftimi i deputetit të Kuvendit, Sasha Gjokiq, për tërheqje nga Grupi Parlamentar i SLS-së

Kryesia u njoftua se deputeti i lartëpërmendur ka dalë nga Grupi Parlamentar i SLS-së. Ndërsa, lidhur me aktivitetet e tij parlamentare të mëtejme se cilit grup parlamentar dëshiron t'i bashkëngjitet apo do të veprojë si deputet i pavarur, duhet të njoftohet Kryesia e Kuvendit.

3.7 Njoftimi i Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Turqi, nga data 31 tetor deri më 4 nëntor 2011

Kryesia u njoftua për vizitën e Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, të realizuar në Turqi, më 31 tetor deri më 4 nëntor 2011.

4. Të ndryshme:

1. Njoftimi i nënkryetarit të Kuvendit z. Petar Miletqi për mos nxjerrjen e vizës për udhëtim zyrtar

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me njoftimin e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Zyra për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare e Kuvendit të Kosovës që të përgatit dhe Kryesisë t'ia paraqesë një informatë për mos realizimin e marrjes së vizës për nënkryetarin e Kuvendit z. Petar Miletqi, për pjesëmarrje në mbledhjen e Asamblesë Parlamentare të NATO-s, në Londër.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **10:35** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.